

|                                                                                                                                                           |                                                      |                     |                                                                                                                                                          |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------|---------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <br><b>Republika e Kosovës</b><br>Republika Kosova<br>Republic of Kosova | <b>DREJTORIA PËR PLANIFIKIM<br/>URBAN DHE MJEDIS</b> |                     | <br><b>Komuna e Istogut</b><br>Opstina Istok<br>Municipality of Istog |
|                                                                                                                                                           | Nr. I lëndës<br>11-351-34114/74                      | Datë:<br>09.08.2022 |                                                                                                                                                          |

Bazuar në Ligjin e Ndërtimit, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për Procedurën Administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura me nr. të kërkesës 11-351-34114 të dt. 09.08.2022 në emër të Bashkim Haxhijaj, Komuna e Istogut, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedis në Istog lëshon këtë:

## VENDIM PËR LEJE NDËRTIMORE

| Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet: |                              |         |  |
|---------------------------------|------------------------------|---------|--|
| Emri:                           | Bashkim Haxhijaj, pronar     |         |  |
| Adresa:                         | rr. "Rexhë Destani" në Istog |         |  |
| Telefoni:                       | [REDACTED]                   | Emaili: |  |

|                      |                                                                      |         |  |
|----------------------|----------------------------------------------------------------------|---------|--|
| Emri i Projektit:    | <b>NDËRTESE PËRCJELLËSE-GARAZHË DHE MURI RRETHUES</b>                |         |  |
| Emri i Projektuesit: | 1. <b>Drilon Isufaj, ark. Dip.</b><br>2. <b>Zekë Ibrahimaj, idgj</b> |         |  |
| Adresa:              | Studio projektuese "Arch-ART." rr. "Ibrahim Rugova" në Istog         |         |  |
| Telefoni:            | [REDACTED]                                                           | Emaili: |  |

| Për punët ndërtimore në vijim:       |                                                                             |                  |
|--------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|------------------|
| Adresa: rr. "Rexhë Destani" në Istog |                                                                             |                  |
| Zona(t) Kadastrale:<br><i>Istog</i>  | Nr. i parcelave kadastrale: <i>00673-19</i><br><i>dhe 00673-20 ZK Istog</i> | GPS Koordinatat: |

| Lloji i ndërtimit të propozuar:                  |                                    |                                  |
|--------------------------------------------------|------------------------------------|----------------------------------|
| Ndërtim i ri <input checked="" type="checkbox"/> | Rindërtim <input type="checkbox"/> | Riparim <input type="checkbox"/> |
| Kategoria e ndërtimeve të propozuara:            |                                    |                                  |

|                                                                                                                                                |                                                                                                    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kategoria I <input type="checkbox"/>                                                                                                           | Kategoria II <input type="checkbox"/>                                                              |
| <b>Përdorimi i propozuar:</b>                                                                                                                  | A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> |
| Përshkrimi: Ndërtesë përcjellëse – garazhë dhe muri rrethues në Istog për të cilën pala ka shlyer detyrimet sipas rregullores komunale 02/2022 |                                                                                                    |

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore Bashkim Haxhijaj pronar lejohet ndërtimi i Ndërtesës përcjellëse – garazhë dhe muri rrethues në Istog.

#### **Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
  - informata mbi Lejen Ndërtimore
  - informatat mbi projektuesin
  - informata mbi kontraktuesin
  - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistrin e hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - protokollet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
    - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me KN, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
    - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
    - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

## Arsyetim

Aplikuesi Bashkim Haxhijaj nga Istog, me nr. të kërkesës 11-351-34114 të dt. 05.08.2022 ka kërkuar nga organi kompetent DPUM lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin, Ndërtesë përcjellëse – garazhë dhe muri rrethues në parcelën kadastrale nr. 00673-19 dhe 00673-20 ZK Istog, në Istog.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjin Nr.02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Dokumentacioni pronësor juridik
- Tri kopje të projektit ideor dhe kopje elektronike - për Kategorinë e I-rë
- Dëshmi mbi zotimin e mjeteve për pagesën e taksave
- Te tjera

**Shtojcë:** Lejës së ndërtimit i bashkëngjitet: situacioni i ngushtë, dispozita urbanistike e pozicionimit të bobjektit me koordinata, në sistemin koordinativ KOSOVAREF01.

**Udhëzim juridik:** Pala e paknaqur me këtë vendim, përnes kësaj Drejtorie, me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI në Prishtinë brenda afatit prej 30 ditësh bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet: parashtruesit të kërkesës QSHQ, kësaj Drejtorie, Drejtorisë për inspektim dhe Arkivës.

Udh. I sektorit

Ark. Rexhep Blakaj id,



Drejt. Dukagjin Hoxhaj,